



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Personat e Pagjetur dhe Peticione
Nr. 0-12
Prishtinë, më 17.6. 2008, në orën 13:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

i mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Personat e Pagjetur dhe Peticione

Morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviç, Sanije Alijaj,
Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Drita Maliqi, Shpresa Murati, Naim
Rrustemi dhe Vezira Emrush - anëtarë.

Kryetari ia propozoi Komisionit këtë

REND DITE

- 1 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
- 2 Shqyrtimi i disa peticioneve
- 3 Të ndryshme

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

U hap diskutimi për pikën e parë:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i disa peticioneve

Ismet Beqiri – I përshëndeti anëtarët dhe i njoftoi se ç'farë qëndrimi do të marrë Komisioni në këtë pikë për se cilin peticion. Pra, kjo tregon se po u ndihmojmë qytetarëve për zgjidhjen e problemeve të tyre për aq sa lejohet me Rregulloren e punës së Kuvendit.

Prof Dr. Nrxhivane Dauti – Në cilësi të raportueses për peticione vuri në pah se po bëhet një punë e madhe me shqyrtimin e peticioneve të legjislaturës së kaluar që kanë mbetur pa u shqyrtuar. Ajo në fillim i njoftoi anëtarët për përmbajtjen e peticioneve dhe ia rekomandoi Komisionit mënyrën e zgjidhjes së tyre.

Shkresa nr. 02-3566, e datës 16. 7. 2007, e ushtruar nga disa nënshkrues anonimë, në të cilën jepen disa hollësi gjatë vuajtjes së burgut në vitin 1999. Komisioni konsideron se shkresa e ofruar nuk ka objekt, prandaj kjo duhet t'i kthehet hartuesit.

Shkresa nr. 02-3914, e datës 31. 10. 2007, e ushtruar nga Hysen Ibra nga Prishtina për shkak se nuk i është dhënë leje për ndërtimin e nënkulmit të banesës që gjendet në lagjen "Ulpiana" D-9, hyrja 8, nr 21. Komisioni lidhur me këtë shkresë vendosi ta pezullojë procedurën pasi u njoftua se ushtruesi i saj kishte vdekur.

Shkresa nr. 01-172, e 13. 08. 2007, e ushtruar nga OJQ-të "Bregu i Veriut" nga Mitrovica, që ankohen për problemet me të cilat ballafaqohen, siç janë: punësimi dhe siguria. Njëkohësisht kërkojnë t'u mundësohet strehimi ekonomik deri sa të stabilizohet gjendja në pjesën veriore të Mitrovicës.

Naim Rrustemi - Duke u ndërlidhur me peticionin që ishte objekt i diskutimit shtoi: Peticionit t'i jepet demension politik, pasi bëhet për sigurinë e qytetarëve. Duke u solidarizuar me shqetësimet e tyre, ishte i mendimit se për vendimet e Komisionit duhet të njoftohen Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit e mbështetën parafolësin. Komisioni e mbështeti shkresën dhe e këshillon palën t'u drejtohet Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Shkresa nr. 03 – 0610 ID – 324, e datës 21. 05. 2008, e Këshillit të TMK-së, prej 82 pjesëtarëve, me të cilën kërkohet - derisa te miratohet Ligji për pensionim të parakohshëm për pjesëtarët e TMK-së - t'u u paguhet shuma mujore nga 75 euro dhe të zbatohet vendimi i Qeverisë Çeku nr. 042332 i datës 10. 01. 2007. Komisioni rekomandon që peticioni t'u dërgohet Komisionit Parlamentar për Siguri dhe Mbrojtje, Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Zyrës së Kryeministrit. Po ashtu kërkon nga institucionet shtetërore sa është punuar në këtë drejtim dhe që Komisioni të informohet për këtë rrjedhë.

Shkresa nr. 02 – 2974, e datës 28. 01. 2007, e parashtruar nga Halime Tashevci, që ka të bëjë me kërkesën për zgjidhjen e drejtë të çështjes së pronësisë së banesës. Komisioni konsideron se ankuesja mund ta realizojë të drejtën nëpërmjet gjykatës ose Agjencionit të Pronave që është formuar sipas Pakos së Ahtisarit dhe merret me rastet e këtilla.

Shkresa nr. 03 – 0609 / DO, e datës 21. 05. 2008, e parashtruar nga familja Zabelaj, në të cilën theksohet se në vitin 1986, pa vullnetin e saj, ish-pushteti serb e shpërnguli me dhunë nga Batusa në Sllatinë. Më tutje theksohet se atje i kishe blerë 4.00,000 ha, por si ndërrim iu ofruan 6.00,000 ha që deri më tani 2.00,000 ha nuk iu dhanë, gjithashtu nuk është bërë kalimi i kësaj palujtshmërie në emrin e saj. Raportuesja ishte e mendimin se për këtë çështje ajo duhet t'i drejtohet Kuvendit Komunal të Prishtinës dhe të kërkohet përgjigje se cilat veprime janë ndërmarrë. Me propozimin e saj u pajtua edhe znj. Sanije Alijaj. Komisioni konsideron se ankuesi duhet t'i drejtohet Kuvendit të Prishtinës për shqyrtimin e kërkesës me qëllim që të njoftohet Komisioni për masat që janë ndërmarrë për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Shkresa nr. A-nr. 211/08, e datës 26. 05. 2008, e ushtruar nga Avokati i Popullit për vërejtjet që i ka gjetur në pëlqimin e MMPH-së për shpalljen e planit rregullator të Prevallës nga ana e KK të Prizrenit. Avokati i Popullit konsideron se veprimi që u mor është në kundërshtim me nenin 12.3 të Ligjit për planifikimin hapësinor. Komisioni konsideron se ankesa mund të jetë e bazuar, por vendosi t'ia përcjellë ministrisë përkatëse.

Shkresa nr. 302 – 10. 06. 2008, e parashtruar nga Organizata e Basketbollit e Kosovës, me të cilën kërkohet hartimi i Projektligjit të kësaj fushe.

Drita Maliqi - Vuri në pah se gjatë hartimit të legjislacionit grupi i punës duhet t'i marrë sugjerimet e ekspertëve dhe t'i inkorpojë ato nëse konsiderohen të dobishme. Me diskutimin e saj u pajtua kryetari dhe të pranishmit. Gjithashtu, u konstatua se Projektligji në fjalë i është kthyer Qeverisë së Kosovës për ripunim.

Shkresa nr. ZS 10/8, e datës 25. 01. 2008, e ushtruar nga Feim Hoti, me të cilën kërkohet përmbushja e kontratës së shitblerjes. Pas shqyrtimit të kërkesës Komisioni i sugjeron palës që për realizimin e të drejtave për përmbushjen e detyrimeve t'i drejtohet gjykatës kompetente.

Prof. dr. Nerxhivane Dautin për punën që është duke e bërë për zgjidhjen e peticioneve e falënderuan kryetari dhe anëtarët e Komisionit.

3. Të ndryshme

Kryetari i njoftoi anëtarët se më 24. 06. 2008 do të shkojë në takim pune jashtë Kosovës dhe e autorizoi z. Hajredin Hyseni, zëvendëskryetar i parë, ta udhëheqë mbledhjen e Komisionit.

Nerxhivane Dauti - E njoftoi Komisionin për takimin që do të mbahet në “Vila Gërmi” dhe apeloj t’i përgjigjen ftesës.

Sanije Alijaj - Shtroi pyetje se sa projekte komunale janë realizuar për kthimin e të shpërngulurve dhe kërkoi që Komisioni të ketë informacion më të plotë.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 30

Procesverbalin e hartoi
Rrahim Demaj - zyrtar i lartë ligjor

Kryetari i Komisionit
Ismet Beqiri